



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK**

Nr. 2524/10 Prot.

Tiranë, më 20.10 2025

V E N D I M

Nr. 129 dt. 20.10. 2025

**“PËR
MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË RREGULLOREN PËR ORGANIZIMIN DHE
FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT TË SIGURIMIT TË CILËSISË DHE
KURRIKULAVE, E NDRYSHUAR”**

Mbështetur në nenin 3 paragrafi 4, pika a, nenin 33 paragrafi 3, nenin 37, nenin 38 të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin nr. 57 datë 29.01.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës”, në nenin 7 paragrafi 4 pika b, nenin 20, nenin 26 të Statutit të UST-së, në nenin 7 të Rregullores së UST-së, Vendimin e Rectoratit Nr.120 datë 14.10.2025, Senati Akademik në mbledhjen e datës 20.10.2025,

V E N D O S I :

1. Miratimin e ndryshimeve në Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Sigurimit të Cilësisë dhe Kurrikulave. (bashkëlidhur vendimit)
2. Neni 3 pika 2 ishte:

Komisioni për Kurrikulat ka në përbërje të tij 5 (pesë) anëtarë, ku 4 (katër) anëtarët e këtij Komisioni, të cilët janë staf akademik zgjidhen nga Senati akademik mbi bazë të vetëkandidimit të personelit akademik. Anëtari i pestë është student dhe zgjidhet nga Këshilli Studentor. Njëri prej anëtarëve të këtij komisioni vjen si propozim i Rectoratit të UST-së, si dhe kandidaturat për përfaqësues të studentëve vijnë të listuara nga Këshilli Studentor.

Anëtarët e këtij Komisioni zgjidhen për një mandat 2 (dy) vjecar, me të drejtë rizgjedhjeje.

Bëhet:

Komisioni për Kurrikulat ka në përbërje të tij 5 (pesë) anëtarë, ku 4 (katër) anëtarët e këtij Komisioni, të cilët janë staf akademik zgjidhen nga Senati akademik mbi bazë të vetëkandidimit të personelit akademik. Anëtari i pestë është student dhe zgjidhet nga Senati

akademik mbi bazë të vetëkandidimit. Anëtarët e këtij Komisioni zgjidhen për një mandat 2 (dy) vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.

3. Ky Vendim i përcillet për njohje të gjitha njësive përbërëse të UST-së, si dhe Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve e Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore për publikim.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Agron KASA

